

❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISE

Gener 2 është një nga kompanitë më të mëdha private të ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Portofoli i Gener 2 është i diversifikuar në zhvillimin e industrive të tilla si: ndërtim, infrastrukturë dhe menaxhim projektsh inxhinierike, energji dhe telekomunikacion, menaxhim pronash, pasuri të paluajtshme dhe media. Gjatë 20 viteve të fundit, Gener 2, ka lënë gjurmë në tregun shqiptar dhe atë rajonal duke zhvilluar projekte strategjike me standartet më të larta ndërkombëtare e njëkohësisht duke kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

❖ TITULLI I POZICIONIT TE PUNES

Inxhinier Mekanik ne Mirembajtje

❖ PERSHKRIMI I POZICIONIT

Inxhinieri Mekanik miremban sistemet dhe pajisjet mekanike dhe hidraulike ne godine me qellim sigurimin e funksionimit te tyre, ruajtjen e cilesise dhe rritjen e eficences.

❖ DETYRAT KRYESORE

- Kontrollon periodikisht dhe ndjek ecurine e punes se sistemeve mekanike & hidraulike (HVAC, hidrosanitar, MKZ, fasade, mekanizma (dyersh, dritaresh etj), ashensore, me qellim per te siguruar funksionimin normal dhe pa nderprerje te impianteve/pajisjeve/ mekanizmave;
- Ndjek ecurine e punes se sistemit HVAC, vlereson rregjimin e temperaturave te vendosura ne objekt, dhe propozon ndryshimet perkatese qe duhet te behen ne nivelin e temperaturave te paravendosura (set-point) si edhe ne rregjimin e punes se paisjeve qendrore (çillerat, UTA, kompresore etj);
- Pergatit dhe organizon te gjitha projektet e reja apo modifikimet ne sistemet nen pergjegjesi, si me poshte:
 - a) Azhornon dhe pergatit ne format inxhinierik (psh Autocad) planimetrite e ambienteve perkatese te sistemeve nen pergjegjesi.
 - b) Modifikon dhe azhornon skemat principale te sistemeve nen pergjegjesi.
 - c) Kryen specifikimet teknike /pergatit preventivat dhe grafikun e kryerjes se punimeve ne sistemet nen pergjegjesi;
 - d) Ndjek dhe organizon kryerjen e punimeve per zbatimin e projekteve te reja apo dhe modifikimeve ne sistemet nen pergjegjesi.
 - e) Kryen testime, kontrole te skemave “*as-built*” dhe situacionet perfundimtare ne baze te projekteve.
- Pergatit, paraqet per miratim te eprori dhe administron Planet per Kontrollet, Sherbimet dhe Mirembajtjen Teknike (PKSHMT) per sistemet nen pergjegjesi;
- Zbaton me korrektësi rregullat e etikës dhe disiplinës në punë;
- Organizon drejtimin e operatoreve teknik-mekanik & hidraulik ne rastet e evidentimit te problemeve te ndryshme mekanike dhe hidraulike ne sisteme dhe paisje;
- Pergatit dhe ndjek procedurat per zbatimin e masave te sigurise ne pune te personelit teknik mekanik;
- Teston dhe vlereson nperiodikisht, por jo me pak se nje here ne muaj, personelin e sigurise per sistemet MKZ (hidrante dhe sprinkler, bombola me gaz dhe pluhur, etj. si edhe te ashensoreve ne rast defekti dhe bllokim te personave ne kabinat e tyre.

❖ KRITERET KRYESORE

Edukimi: Inxhinier Mekanik. Preferohet: Te kete specializime/certifikata te ndryshme ne fushat e inxhinierise mekanike & hidraulike.

Gjuhe te huaja: Anglisht, Italisht (nivel mesatar).

Njohuri kompjuterike: Paketa MSc Office, Autocad.

Eksperienca e kerkuar: Mbi 3 vjet experience pune. Preferohet ne pozicione te ngjashme.

Te gjithë te interesuarit, jane te lutur qe te dergojne CV nepermjet adreses se e-mailit careers@gener2.al ose te plotesojne formularin e aplikimit ne faqen zyrtare www.gener2.al ne seksionin “apliko online”.

Afati i fundit i aplikimit eshte **data 20 Gusht 2022, ora 17:00**.

* Vetem kandidatet e perzgjedhur do te kontaktohen.

* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 mbi “Mbrotjtjen e të dhënave personale”.